

- Telefon24 -

Shërbimi telefonik për lajmërimin e mungesave në gjuhën shqipe

Informacion mbi Telefon24

Telefon24 ka filuar punën. Telefon24 është një shërbim telefonik i automatizuar i Skola24, ku Ju si prindër mund të lajmëroni mungesat e fëmijës/fëmijëve Tuaj në shkollë. Për ta përdorur këtë shërbim nuk keni nevojë për të pasur një konto në Skola 24. E vetmja gjë që Ju duhet është një telefon me butona.

Lajmërimi i mungesave mund të bëhet në gjuhët e mëposhtme:

0515 777 000	Suedisht
0515 777 001	Anglisht
0515 777 002	Arabisht
0515 777 003	Somalisht
0515 777 004	Pashto
0515 777 005	Shqip

Duke përdorur butonat e telefonit, Ju jepni numrin personal të fëmijës dhe në këtë mënyrë lajmërimi i mungesës kalon drejtpërdrejt në bazën e të dhënave, pa pasur nevojë që personeli i shkollës të merret me këtë çështje.

Kini kujdes që lajmërimin e mungesës ta bëni para orës 12.00, me qëllim që ky lajmërim të vlejë për ditën kur po telefononi.

Për momentin, lajmërimi i mungesës mund të bëhet vetëm për një ditë të plotë. Nëse telefononi pas orës 12, atëherë lajmërimi i mungesës do të vlejë për ditën e nesërme.

Ekziston mundësia që lajmërimin e mungesës ta ndërprisni kur të doni gjatë telefonatës. Kur regjistrimi të jetë kryer, Ju do të dëgjoni një kërkesë për ta vërtetuar lajmërimin. Nëse ju e mbyllni telefonin para këtij momenti, atëherë regjistrimi ndërpritet.

Numrat personale të nxënësve duhet të regjistrohen në mënyrë të rregullt me 10 shifra.

Ata prindër, që kanë një konto hyrëse në Skola24, mund ta shohin lajmërimin e mungesës në fushën e komenteve ku bie në sy numri i telefonit prej nga është bërë lajmërimi. Përjashtim bën rasti kur lajmërimin e mungesës e bëni përmes

një telefoni me numër të fshehtë ose përmes një çentrali telefonik, i cili nuk tregon numrin e telefonit.

Personeli i shkollës mund të shohë kohën e saktë se kur është bërë lajmërimi si dhe numrin e telefonit prej nga është bërë ky lajmërim. Mësuesi i nxënësve mund e shoh këtë informacion sapo të ketë hyrë në faqen fillestare të Skola24.

- Telefon24 -

Shërbimi telefonik për lajmërimin e mungesave

Informacion fillestar rreth Telefon24

Jeni të mirëseardhur për të filluar me përdorimin e shërbimit telefonik mbi lajmërimin e mungesave në gjuhën shqipe përmes telefonit me butona. Shërbimi është i lidhur dhe i gatshëm për përdorim.

Numri, që do të përdorni në gjuhën shqipe, është **0515-777 005**.

- Përshëndetja e mirëseardhjes tingëllon si më poshtë:

"Përshëndetje dhe mirësevini nëSkola24, sistemi i lajmërimit të mungesave për qytetin e Malmö-s.

Keni telefonuar para orës 12, prandaj dhe mungesa do të regjistrohet për ditën e sotme.

(Alternativa e dytë: Keni telefonuar pas orës 12, prandaj dhe mungesa do të regjistrohet për ditën e nesërme.)

Ju lutemi, bjerini numrit personal 10-shifror të nxënësit/nxënëses."

Kur regjistrimi të ketë përfunduar, zëri telefonik vërteton regjistrimin:

"Lajmërimi i mungesës, që keni bërë, është regjistruar. Mos harroni të lajmëroni mungesën për çdo ditë. Ju falenderojmë për telefonatën."

Vini re!

- Para se të telefononi, sigurohuni që keni para vetes numrin personal 10-shifror të fëmijës.
- Për momentin, lajmërimi i mungesës mund të bëhet vetëm për një ditë të plotë. Prandaj, lajmëroni fëmijën/fëmijët për çdo ditë që ata mungojnë. Vini re që lajmërimi i mungesave duhet të bëhet para orës 12.00, që ky lajmërim të mund të vlejë për ditën kur po telefononi. Mungesat, që lajmërohen pas orës 12.00, regjistrohen për ditën e nesërme.
- Ekziston mundësia që lajmërimin e mungesës ta ndërprisni kur të doni gjatë telefonatës. Kur regjistrimi të jetë kryer do të dëgjoni një vërtetim. Nëse e mbyllni telefoni para se të vijë ky vërtetim, atëherë regjistrimi ndërpritet.

- Telefon24 -

Shërbimi telefonik për lajmërimin e mungesave

Telefon24 - Demonstrim

Ekziston një numër telefoni, që demonstroi mënyrën se si është ndërtuar dhe si funksionon ky shërbim. Demonstrimi është në suedisht.

Telefononi: 0515-777629

Lajmëroni mungesën për nxënësin: 112233-1232 ose 112244-1239

Fotografia e mëposhtme tregon se si duket në kompjuter lajmërimi për mësuesin e klasës:

Visa översikter för:

Översikt: Frånvarande mentorselever idag (0st)

Översikt: Frånvarande elever på mina lektioner idag, (1st)

En, 08:20-09:30, - 1 frånvarande elev

Namn	Klass	Frånvaro	Anledning	Kommentar
Svensson, Hanna	9A	70min	Anmäld	Inringt 2007-08-07 (11:01) av: 0515777888